

17 gusht 2026,
Prishtinë

Vendim i Bordit të FBK-së i datës 17.08.2026, Prishtinë

Lirimi nga obligimet financiare për kuotizim dhe regjistrim të lojtarëve për klubet e KB Policia e Kosovës – Meshkujt dhe Femrat për edicionin garues 2026/27

Në përputhje me kompetencat e Bordit të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) që rrjedhin nga Statuti i FBK-së, përkatësisht neni 24, si dhe duke marrë parasysh kërkesën e pranuar nga KB Policia e Kosovës, Bordi i FBK-së, pas shqyrtimit të kërkesës dhe rrethanave të paraqitura, vlerëson se, duke qenë se klubet janë të reja dhe përballen me mundësi të kufizuara për sigurimin e sponsorizimeve dhe mbështetjes financiare, lirimi nga obligimet për kuotizim dhe regjistrim të lojtarëve për edicionin 2026/2027 përbën një masë të arsyeshme mbështetëse për lehtësimin e pjesëmarrjes dhe konsolidimin e tyre në garat e FBK-së.


Rrjedhimisht, Bordi i FBK-së vendos:

1. **Aprovohet** kërkesa e klubeve të Policisë së Kosovës (Meshkujt dhe Femrat) për lirimin nga obligimet financiare për kuotizim dhe regjistrim të lojtarëve për edicionin garues 2026/2027.
2. Lirimi nga këto obligime vlen vetëm për edicionin garues 2026/2027 dhe nuk përbën bazë për përjashtim nga obligimet për edicionet e ardhshme.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata e FBK-së.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij.

Në emër të Bordit të FBK-së,

Arben FETAHU



Federata e Basketbollit të Kosovës

